

Tatimet në Zvicër

Shuma e tatimeve që duhen paguar ndryshon nga një kanton në tjetrin dhe nga një komunë në tjetrën. Për individët privatë, tatimet më të rëndësishme lidhen me të ardhurat (pagën dhe të ardhura të tjera), pasurinë dhe TVSH-në.

Sistemi i tatimeve (ose sistemi i fiskalizimit)

Për të financuar shërbimet e vendit, autoritetet zvicerane mbledhin tatime. Në Zvicër, ekzistojnë disa autoritete të ndryshme: Konfederata, kantonet, komunat dhe gjithashtu kishat kombëtare. Autoritetet mbledhin paratë në 2 mënyra të ndryshme:

- nëpërmjet tatimeve të drejtpërdrejta të paguara nga individët. Këto tatime janë llogaritur në të ardhurat dhe pasurinë e çdo personi.
- nëpërmjet tatimeve indirekte, siç janë TVSH-ja, taksa e duhanit ose taksa e naftës minerale. Kjo taksë (ose detyrim) paguhet kur blini këto mallra. Kjo taksë përfshihet në çmimin e mallrave.

Kantonet dhe komunat vendosin vetë për tarifat për tatimet direkte. Kjo është arsyeja pse ka dallime nga një komunë në tjetrën. Çiftet e martuara taten bashkërisht. Ata paraqesin një deklaratë të vetme tatimore për të dy.

Tatimi i mbajtur në burim

Në Zvicër, disa njerëz nuk marrin një deklaratë tatimore. Tatimet e tyre zbriten direkt nga paga e tyre. Kjo quhet "tatim i mbajtur në burim".

Sistemi i tatimit në burim përdoret kryesisht për:

- persona të huaj që jetojnë në Zvicër dhe që nuk kanë një leje C.

Kujdes: Personat të cilët nuk kanë leje C, por të cilët janë të martuar me një shtetas Zviceran ose me leje C, nuk i nënshtrohen tatimit në burim.

- persona të huaj që punojnë në Zvicër, por jetojnë jashtë vendit (për shembull, punëtorë ndërkufitarë).

Si funksionon?

Tatimi në burim mbahet direkt në pagën e punonjësit, çdo muaj.

Punëdhënësi kujdeset për këtë: ai njofton këtë punonjës tek autoritetet tatimore dhe paguan taksën për të.

Shuma e taksës varet nga disa faktorë:

- të ardhurat,

- statusi civil (beqar, i martuar, etj.),
- numri i fëmijëve.

Nëse ndryshon statusi civil (për shembull: martesë ose lindja), personi duhet të njoftojë menjëherë punëdhënësin e tij. Kjo mund të ndryshojë shumën e taksës.

A e paguani tatimin në burim?

Ju mund të kërkonti kompensim për shpenzimet!

Nëse paguani shpenzime të caktuara (për shembull, një kontribut pensioni – shtylla e 3-të A), mund t'i deklaroni këto shpenzime. Për ta bërë këtë, më vonë kërkonti një kërkesë për një vlerësim të zakonshëm tatimor të mëvonshëm nga Service des contributions (Departamenti i Tatimeve). Kjo quhet: tatim i zakonshëm pasues (TOU). Aplikimin mund ta bëni deri më 31 mars të vitit të ardhshëm. Pastaj do të merrni një formular për ta plotësuar.

TOU i detyrueshëm në Jura

Në kantonin Jura, disa persona që taten në burim duhet të dorëzojnë një deklaratë të zakonshme tatimore pasuese.

Këta janë njerëzit të cilët kanë:

- një pasuri e tatueshme (p.sh., paratë në llogaritë bankare)
- ose të ardhura të tjera, përveç pagës (p.sh. nga qiraja

nga një banesë me qira).

Nëse kjo vlen për ju, ju duhet t'i shkruani Service des contributions (Departamenti i Tatimeve). Pastaj do të merrni një formular.

Cilat janë hapat e mëtejshme?

Pasi deklarata është bërë, ju merrni:

- një përlllogaritje për të treguar se sa keni ende borxh (ose çfarë është paguar tashmë),
- dhe më pas, një faturë ose një rimbursim në varësi të situatës.

Më pas, do të duhet të dorëzoni një deklaratë tatimore çdo vit, edhe nëse tateni në burim.

Ku mund të marr ndihmë ?

Ju mund të gjeni të gjitha informacionet në faqen e internetit të Service des contributions (Departamenti i Tatimeve).

Tatimet e rregullta

Njerëzit me një pasaportë zvicerane ose leje qëndrimi C zakonisht taksohen (ose tatohen). Çdo vit, ata duhet të plotësojnë deklaratën tatimore. Pastaj ata i paguajnë tatimet e tyre me një faturë.

Deklaratën e merrni me postë. Ju keni disa opsione për të plotësuar:

- në një formular letre,
- në Jura-Tax, të cilën e shkarkoni nga interneti ose nëpërmjet CD-së,
- ose në portalin virtual të kantonit Jura.

Plotësimi i formularëve tatimorë nuk është i lehtë.

Është e këshillueshme që të merrni ndihmë kur plotësoni një deklaratë për herë të parë.

Ose kur dikush zotëron pasuri të paluajtshme (shtëpi, ndërtesa), për shembull.

Platforma Impôts.easy shpjegon se si të plotësoni deklaratën tuaj tatimore me shembuj konkretë.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/parat-dhe-tatimet/tatimet-ne-zvicer